REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**
**K.P.P. 451/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Vilma Zhupaj | Anëtar |
| Lindita Skeja | Anëtar |
| Merita Zeqaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 16.10.2020 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Alstezo” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. *REF-64933-07-09-2020* me objekt: “*Riparim, mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan*”, me fond limit *2,832,800* lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën *21.07.2020*, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Alstezo” sh.a.
*Adresa: Lagjia “Kryengritja e Fierit”, Rr. “Aulona”, Fier.*

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
*Adresa: Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë.*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”,* i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,* i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesës të ankimuesit.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10.07.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit "*Kërkesë për propozim*", me nr. *REF-64933-07-09-2020* me objekt: "*Riparim, mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan*", me fond limit *2,832,800* lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën *21.07.2020,* nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 21.07.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, autoriteti kontraktor në datë 30.07.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Alstezo”sh.a 1.999.700 lekë, Skualifikuar
2. “Kadiu” sh.a. 2.192.300 lekë, kualifikuar

II.4. Në datën 30.07.2020 operatori ekonomik “Alstezo”sh.p.k., është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si më poshtë:
*Ofertuesi nuk arriti të paraqesë dokumentacion provues për elementet e vecanta të ofertës ekonomike anomalisht të ulët sipas nenit 56 të LPP-së, e konkretisht në shkresën me nr.34/1prot., datë 28.07.2020 me lëndë: “Dorëzim dokumentacioni lidhur me sqarimin e ofertës ekonomike” të protokolluar në organin qendror blerës ABP me nr. 1499/1 prot., datë 29.07.2020, rezulton se: - Referuar dokumentacionit dhe tabelës së paraqitur nga vetë ofertuesi “ALSTEZO” SHA, të emërtuar “Tabela përmbledhëse me të dhënat për sqarimin e ofertës ekonomike”, mungon dokumentacioni provues dhe sqarues për cmimet për njësi për 1(një) zë shërbimi e konkretisht për automjetin: Autoveturë, Marka: Chevrolet , Tipi Aveo, Viti i Prodhimit 2009, Lënda djegëse Benzine,Nr. Shasisë: KL1SF48WJAB040476, për zërin e shërbimit: “Furnizim&vendosje sensor oksigjeni”; - Referuar dokumentacionit dhe tabelës së paraqitur nga ofertuesi “ALSTEZO” SHA, të emërtuar “Tabela përmbledhëse me të dhënat për sqarimin e ofertës ekonomike”, mungon dokumentacioni provues dhe sqarues për cmimet për njësi për zërat e shërbimeve për automjetet si më poshtë: I. Lloji: Autoveturë, Marka: Chevrolet , Tipi Aveo, Viti i Prodhimit 2009, Lënda djegëse Benzine ,Nr. Shasisë: KL1SF48WJAB040476 e konkretisht:*
*1.Furnizim&vendosje rryp faze motori;*
*2. Furnizim&vendosje guarnicion testate;*
*3. Furnizim&vendosje bobinë ndezje;*
*4.Furnizim&vendosje termostat nxehtësie;*
*5. Furnizim&vendosje freksioni;*
*6. Furnizim&vendosje pompë freksioni e poshtme;*
*7. Furnizim&vendosje kushinet moco rrote e pasme*
*8. Furnizim&vendosje disk frenimi të parë*
*9. Furnizim&vendosje ferrota frenimi të para*
*10. Furnizim&vendosje ferrota frenimi të pasme*
*11. Furnizim&vendosje krah avantreni të poshtëm*
*12. Furnizim&vendosje gomina krah avantreni të mëdha;*
*13. Furnizim&vendosje gomina ekuilibrator të pare;*
*14. Furnizim&vendosje kushinet suport amortizatori;*
*II. Lloji: Fuoristrad, Marka: Land Rover, Tipi Defender, Viti i Prodhimit 2000, Lënda djegëse Diezel Nr. Shasisë: SALLDHMF8VA134072Nr. Shasisë: WVWZZZ1KZ5W006263, e konkretisht:*
*1. Furnizim&vendosje freksioni*
*2. Furnizim&vendosje pompë freksioni e poshtme*
*3. Furnizim&vendosje kryq transmesioni*
*4. Furnizim&vendosje kushinet moco rrote e pasme*
*5. Furnizim&vendosje kushinet moco rrotë e pare*
*6. Furnizim&vendosje kokë paraleli*

*7. Furnizim&vendosje ferrota frenimi të para*
*8. Furnizim&vendosje ferrota frenimi të pasme*
*III. Lloji: Fuoristrad, Marka:Mitsubish, Tipi Pajero, Viti i Prodhimit 2000, Lënda djegëse Diezel; Nr. Shasisë: JMBONV440XJ001908, e konkretisht:*
*1. Furnizim&vendosje grup termostati nxehtësie*
*2. Furnizim&vendosje freksioni*
*3. Furnizim&vendosje pompë freksioni e sipërme*
*4. Furnizim&vendosje pompë freksioni e poshtme*
*5. Furnizim&vendosje këmb ridoto*
*6. Furnizim&vendosje kushinet moco rrote e pasme*
*7. Furnizim&vendosje gjysmëboshte të parë të jashtëm*
*8. Furnizim&vendosje moco rrote të para*
*9. Furnizim&vendosje kushinet moco rrote e parë*
*10. Furnizim&vendosje braço grup timoni*
*11. Furnizim&vendosje kokë paraleli*
*12. Furnizim&vendosje ferrota frenimi të para*
*13. Furnizim&vendosje ferrota frenimi të pasme*
*14. Furnizim&vendosje pompë frenimi*
*15. Furnizim&vendosje kokë krah avantreni sipërm*
*16. Furnizim&vendosje kokë krah avantreni poshtëm*
*17. Furnizim&vendosje stabilizator i parë*
*18. Furnizim&vendosje gomina ekuilibratori të parë*
*19. Furnizim&vendosje gomina ekuilibratori të pasëm;*
*IV. Lloji: Fuoristrad, Marka:Mitsubish, Tipi Pajero, Viti i Prodhimit 2000, Lënda djegëse Benzine; Nr. Shasisë:*
*JMYONA110XJ000115 e konkretisht:*
*1. Furnizim&vendosje termostat sistem ftohje në motor;*
*2. Furnizim&vendosje ferrota frenimi të para;*
*3. Furnizim&vendosje pompë frenimi;*
*V. Lloji: Fuoristrad, Marka : Hyundai, Tipi Galloper Viti i Prodhimit 2000, Lënda djegëse Diezel; Nr. Shasisë:*
*KMXNL1DPVU176236, e konkretisht:*
*1. Furnizim&vendosje braço grup timoni*
*2. Furnizim&vendosje kokë paraleli*
*3. Furnizim&vendosje ferrota frenimi të para*
*4. Furnizim&vendosje kokë krah avantreni sipërm;*
*VI. Lloji: Mikrobuz, Marka : Hyundai, Tipi H-1 Viti i Prodhimit 2014, Lënda djegëse Diezel; Nr. Shasisë:*
*KMHWH81KAFU690324, e konkretisht:*
*1. Furnizim&vendosje freksioni;*
*2. Furnizim&vendosje ferrota frenimi të para;*
*3. Furnizim&vendosje tirantë stabilizator të pasëm*

*Operatori ekonomik "ALSTEZO" SHA, për të gjithë zërat e shrbimeve të citura më sipër ka paraqitur deklarata doganore me anë të të cilave provohet se ka importuar pjesë të ndryshme këmbimi për automjete nga kompania "Japanparts S.r.l", kompani e cila nuk rezulton të jetë deklarur nga ana e ofertuesit si prodhuese ose distributore i autorizuar nga prodhuesi në përpmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën 8 të seksionit 2.3 "Për kapacitetin teknik", pra si një nga kompanitë ku ofertuesi do të furnizohet me pjesë këmbimi origjinale për realizimin e zërave të shërbimeve për automjetet objekti këtijobjekti prokurimi. Përsa më sipër, edhe pas shqyrtimit të të gjithë informacionit të paraqitur, nuk krijohet bindja se oferta është e rregullt në të gjitha elementët e saj në përputhje me nenin 56 të LPP-së, në drejtim të origjinalitetit të mallrave për kryerjen e këtyreshërbimeve kërkesë e përcaktuar në dokumentat e tenderit.*

II.5. Në datën 04.08.2020 operatori ekonomik "Alstezo"sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, me arsyetimin si më poshtë vijon:

*[...]Kemi marre pjese ne proceduren e zhvilluar nga AK Agjensia e Blerjeve te Perqendruara me dt.21/07/2020 Per "RIPARIM DHE MIREMBAJTJE AUTOMJETESH PER DREJTORINE VENDORE TE POLICISE ELBASAN", me Fondi limit/Vlera e pritshme e kontrates eshte 2,832,800 (dy milion e teteqind e tridhjete e dy rnije e teteqind) leke pa TVSH.*

*Ne daten 27.07.2020, nga ana e AK neprmjet SPE, eshte derguar:"kerkese per informacion mbi oferten anomalisht te ulet". Ne pergjigje te kesaj kerkese te AK, kemi derguar argumentimin tone ne dt.28.07.2020 ne SPE. Ne kete pergjigje drejtuar AK ne SPE, kemi dhene spjegimet tona per elementet e vecante te cilet karakterizojne perparesite qe ne si OE kemi sa i perket fakteve, si vijon:*

*Lidhur me zgjidhjet teknike: Shoqeria Alstezo sha ka nje eksperience 27 vjecare (krijuar ne vitin 1993 si autoservis dhe pjese kembimi per automjete) dhe sot eshte shoqeria " lider" ne Shqiperi per riparimin dhe sherbimet e mjeteve si ato private, ashtu edhe shteterore. Kusht favorizues eshte pikerisht fakti qe Shoqeria ka disa pika kontrolli teknik shume funksionale dhe moderne, te cilat sherbejne ne hyrje te mjetit per riparim dhe kontrollin ne dalje te tij. Pikat e kontrollit jane shume moderne dhe plotesojne te gjitha parametrat teknike duke bere te mundur kontrollin e mjetit, pra diagnostikimin e difeketeve dhe percaktimin e gjendjes teknike aktuale te mjetit ne kohe reale lidhur me gjithe proceset e punes te nevojshme gjate kontrollit, si para, ashtu edhe pas procesit te riparimit te mjetit.*

*Ne serviset qe ne disponojme kryhen gjithe proceset e punes per riparim te mjeteve, "nga A ne Z" sikurse jane ato motorrike, elektrike, elektronike, sistem ushqimi, percaktimi i nivelit te gazrave (lidhur me ndotjen e ambjentit) pastrimin e motorrit me H2, pastrimin e marmides katalitike me pajisjet bashkekohore PDF (teknologjie vitit 2019-2020, ... etj.) Reparti i karrocerise (riparimi llamarines dhe bojatisja) jane me modernet ne vend dhe ne rajon duke filluar qe nga repartet e zmontimit te mjetit, drejtimit te shasive, riparimit llamarines, lyerjes me boje ne furra moderne,.etj. Personeli Inxhinierik i shoqerise ALSTEZO sha eshte i specializuar dhe diplomuar ne shtetet perendimore, po ashtu edhe personeli tjeter teknik, i cili eshte i pajisur me deshmite profesionale, te cilat jane te konkretizuara nëpërmjet detyrave te percaktuara ne kontarten e punes perkatesisht per cdo punemarrës në vecanti.*

Sa i perket orgiinalitetit te mallrave, Shoqeria ALSTEZOsha eshte importuese direkt e të gjitha pajisjeve të këmbimit që nevojiten për riparimin e mjeteve. Importi bëhet në rang produkti (multimarket) dhe disponibiliteti i pjesëve të këmbimit është 100% në kohë reale. Për porosi te vecanta emergjente ato organizohen nëpër fabrikat që në bashkëpunojmë dhe kemi partneritet të cilat e dërgojnë pjesën e këmbimit me poste prioritare kështu që propabiliteti mungesa e pjesëve të këmbimit të cfarëdo natyre thuajse 0. Nderkohe, kemi marrdhenie me koncesionaret dhe perfaqesite e pjeseve te kembimit me te fuqishme ne Bari (ltali) gjithashtu per raste emergjente te porosive te vecanta, te cilat sigurohen per 24 ore.
Lidhur me zbatueshmerine e detyrimeve: Shoqeria ALSTEZO sha, ka ambjentet e punes shume bashkekohore dhe me standartet e nje performance Europiane. Nga ana e personelit te shoqerise zbatohen me rigorozitet dhe displine te vazhdueshme te gjitha rregullat e sigurimit teknik. Aktualisht ne menyre te vecante, po zbatohen rregullat e vendosura nga organet kompetente saj perket "Covid 19".
Te gjitha keto perparesi sa me siper, garantojne realizimin e kesaj procedure, pa as mete voglin dyshim. Nderkohe duke e falenderuar KVO paraprakisht per kete bashkepunimin, ne kemi shprehur gatishmerine qe "mbetemi ne dispozicionin e AK per cdo sqarim te metejshem qe mund t 'ju nevojitej, sa me siper " ...
Ne daten 29.07.2020, kemi dorezuar prane AK, dokumentat shkresore, me nr 34/1, dt.28.07.2020, protokolluar nga AK me Nr.2 Prot, date 29.07.2020. Mire po nga ana e AK, nuk u pa e nevojshme per nje bashkepunim te metejshem lidhur me ndonje kerkese apo plotesim me teper, duke bere te mundur sqarimin akoma me ne detaje te metejshme te argumentimit tone voluminoz prej 532 fletesh.
Pikerisht ne momentin kur ne prisnim nje rezultat te pranimit te Ofertes tone, si nje oferte me cmim mete ulet dhe me te gjitha perparesit qe ne kemi ne tregun Shqiptar (shprehur ne argumentim ne menyre te pergjithshme sa me siper) pikerisht ne dt.30.07.2020 jemi njohur ne Sistemin Elektronik te Prokurimit Publik (SPE) me klasifikimin e ofertave me dt.30.07.2020, ne te cilin ne si Operator Ekonomik jemi skualifikuar me aresyetimin, si vijon:
Referojmë arsyet e skualifikimit si më sipër [...]
E kundershtojme kete vendim te KVO per klasifikimin e ofertave, pasi ka bere skualifikim te ofertes tone ne menyre te padrejte, ne kundershtim me rregullat dhe Ligjet e Prokurimit Publik.
Kundershtimin e mbeshtesim pikerisht me argumentimin, si me poshte:
A. Lidhur me pretendimin, si viion:
Referuar dokumentacionit dhe tabeles se paraqitur nga vete ofertuesi "A LSTEZO" SHA, te emertuar "Tabela permbledhese mete dhenat per sqarimin e ofertes ekonomike ". mungon dokumentacioni provues dhe sqarues per cmimet per njesi per I (nje) ze sherbimi e konkretisht per automjetin: Autoveture, Marka: Chevrolet, Tipi Aveo, Viti i Prodhimit 2009, Lendo djegese Benzine, Nr. Shasise: KLISF48ËJAB040476, per zerin e sherbimit: "Furnizim & vendosje sensor oksigjeni";
Theksojme qe ne lidhje me kete artikull (ky eshte vetem 1 artikull dhe eshte bere thjesht nje lapsus) respektivisht te gjithe pjeses se argumentuar ekonomikisht. Pikerisht per kete mund qe AK duhet ta kishte konsideruar si nje devijim te vogel, I cili referuar LPP dhe ne propocion me teresine e

*Ofertes ekonomike, nuk ndikon ne thelbesisht , pra ne themel te vleres se ofertuar nga ana jone. Sa me siper pretendimi i AK per kete pike, nuk qendron.*

*B. Lidhur me pretendimin, si vijon*

*Referuar dokumentacionit dhe tabeles se paraqitur nga ofertuesi "ALSTEZO" SHA, te emertuar "Tabela permbledhese me te dhenat per sqarimin e ofertes ekonomike ". mungon dokumentacioni provues dhe sqarues per cmimet per njesi per zerat e sherbimeve per automjetet si me poshte:*

*I. lloji: Autoveture, Marka: Chevrolet, Tipi Aveo, Viti i Prodhimit 2009, Lende djegese Benzine,Nr. Shasise: KLISF48WJAB040476 e konkretisht:*

*I. Furnizim&vendosje rryp faze motori;*<br>
*2. Fumizim&amp.vendosje guarnicion testate;*<br>
*3. Furnizim&amp.vendosje bobine ndezje;*<br>
*4. Furnizim&vendosje termostat nxehtesie;*<br>
*5. Furnizim&vendosje freksioni;*<br>
*6. Furnizim&vendosje pompe freksioni e poshtme;*<br>
*7. Furnizim&vendosje kushinet moco rrote e pasme*<br>
*8. Furnizim&vendosje diskfrenimi te pare*<br>
*9. Furnizim&vendosje ferrota frenimi te para*<br>
*10. Furnizim&vendosje ferrotafrenimi le pasme*<br>
*11. Furnizim&vendosje krah avantreni le poshtem*<br>
*12. Furnizim&vendosje gomina krah avantreni le medha;*<br>
*13. Furnizim&vendosje gomina ekuilibrator te pare;*<br>
*14. Furnizim&vendosje kushinet suport amortizatori;*

*II. Lloji: Fuoristrad, Marka: Land Rover, Tipi Defender, Viti i Prodhimit 2000, Lenda djegese Dieze/ Nr. Shasise: SALLDHMF8VA / 34072Nr. Shasise: WVWZZZI KZ5 W006263, e konkretisht:*

*1. Furnizim&vendosje .freksioni*<br>
*2. Furnizim&vendosje pompefreksioni e poshtme*<br>
*3. Furnizim&vendosje kryq transmesioni*<br>
*4. Furnizim&vendosje kushinet moco rrote e pasme*<br>
*5. Furnizim&vendosje kushinet moco rrote e pare*<br>
*6. Furnizim&vendosje koke paraleli*<br>
*7. Furnizim&vendosje ferrota frenimi te para*<br>
*8. Furnizim&amp.vendosje .ferrota.frenimi te pasme*

*III. Lloji: Fuoristrad, Marka Mitsubish, Tipi Pajero, Viti i Prodhimit 2000, Lënda Djegëse Diezel, Nr. Shasisë:JMBONV440XJ001908, e konkretisht:*

*1.Furnizime & amp; vendosje grup termostati nxehtësie*<br>
*2. Furnizime & amp; vendosje freksioni.*<br>
*3. Furnizime & amp;pompë freksioni e sipërme*<br>
*4. Furnizime & amp;pompë freksioni e poshtme*<br>
*5. Furnizime & amp; vendosje këmb ridoto*<br>
*6. Furnizime & amp;kushinet moco rrotë e pasme.*

7. Furnizim&vendosje gjysmeboshte te pare tejashte»
8. Furnizim &amp.vendosje moco rrote te para
9. Furnizim&vendosje kushinet moco rrote e pare
10. Furnizim&vendosje braco grup timoni
11. Furnizim&vendosje koke paraleli
12. Furnizim&vendosje ferrota frenimi te para
13.Furnizimdcamp.vendosje ferrota frenimi te pastne
14. Furnizima.amp.vendosje pompefrenimi
15. Furnizim&vendosje koke krah avantreni siperm
16. Furnizim&vendosje koke krah avantreni poshtem
17. Furnizim&vendosje stabilizator i pare
18. Fumizimdcamp.vendosje gomina ekuilibratori te pare
19. Furnizim&vendosje gomina ekuilibratori te pasem;

IV. Lloji: Fuoristrad, Marka.Mitsubish, Tipi Pajero, Viti i Prodhimit 2000, Lendo djegese Benzine; Nr. Shasise: JMYONA110XJ000115 e konkretisht:
1. Furnizim&amp.vendosje termostat sistem ftohje ne motor;
2. Furnizim&vendosje ferrota frenimi te para;
3. Furnizim&vendosje pompe frenimi;

V. Lloji: Fuoristrad, Marka : Hyundai, Tipi Galloper Viti i Prodhimit 2000, Lendo djegese Diezel; Nr. Shasise: KMXNLI DPVU/76236, e konkretisht:
1. Furnizim&amp.vendosje braco grup timoni
2. Furnizim&vendosje koke paraleli
3. Furnizim&vendosje ferrota frenimi te para
4. Furnizimccamp.vendosje koke krah avantreni siperm;

VI. Lloji: Mikrobuz, Marka: Hyundai, Tipi H-1 Viti i Prodhimit 2014, Lendo djegese Diezel; Nr. Shasise: KMHËH8 I KAFU690324, e konkretisht:
1.Furnizim&vendosje freksioni;
2. Furnizim &amp.vendos]e ferrota frenimi te para;
3. Furnizim&vendosje tirante stabilizator te pasem
Operatori ekonomik "ALSTEZO" SHA, per te gjithe zerat e shrbimeve te citura me siper ka paraqitur deklarata doganore me ane te te cilave provohet se ka importuar pjese te ndryshme kembimi per automjete nga kompania "Japanparts Sr.l", kompani e cila nuk rezulton te jete deklaruar nga ana e ofertuesit si prodhuese ose distributore i autorizuar nga prodhuesi ne perpmbushje te kriterit te percaktuar ne piken 8 te seksionit 2.3 "Per kapacitetin teknik", pra si nje nga kompanite ku ofertuesi do te furnizohet me pjese kembimi origjinale per realizimin e zerave te sherbimeve per automjetet objekti ketij objekti prokurimi. Persa me siper, edhe pas shqyrtimit te te gjithe informacionit te paraqitur, nuk krijohet bindja se oferta eshte e rregullt ne te gjitha elementet e saj ne perputhje me nenin 56"te LPP-se, ne drejtim te origjinalitetit te mallrave per kryerjen e ketyre sherbimeve kerkese e percaktuar ne dokumentat e tenderit.

*Lidhur me kete pretendim te AK, sqarojme, si vijon:*
*Nga ana e AK, ne asnje rast nuk eshte kerkuar ndonje kod i percaktuar, apo reference lidhur me origjinalitetin, apo llojin e prodhuesit apo distributorit per pjeset e kembimit qe do te nevojiten per riparimin e mjeteve (ref tabelave te parashtruara ne Shtojcen 10 te DST ne kete procedure prokurimi)*
*Sa i perket artikujve te permendur nga AK ne aresyetimin per skualifikim, theksojme qe ne si OE bashke me oferten tone kemi paraqitur, jo nje, por disa Autorizime prodhuesi i distributori, sikurse jane ato nga Kompanite Febest, Impergom, Orginal Birth, Metelli dhe BGA, të cilëat i trajtojnë në gamën e tyre të prodhimit (manifakturimit) produktet pjesë këmbimi për të gjitha artikujt e kërkuar.*
*Pra e ritheksjomë që aktualisht në DST nga ana e AK-së nuk është kërkuar teknikisht përkatësimi për cdo artikull një për një i orgjinës së blerjes (shitjes nga furnitori)respektivisht zërave te riparimi të paraqitura në ofertë. Nëse në argumentimin ekonomik në tabelë është referuar njëra nga kompanitë me të cilën nga dokumentat e paraqitura nga na jonë pranë AK (referuar kërkesës për OAU)vërtetohet katërcipërisht bashkëpunimi kjo nuk e përjashton argumentimin lidhur me cmimet e ofruara nga ana jonë në këtë ofertë, të cilat janë shprehur një për një për cdo artikull të ofertuar.*
*Në argumentimin tonë për OAU për cdo emërtim "Përshkrim shërbimeve" të ofertuar ne kemi shprehur cmimin e blerjes si dhe shpenzimet përkatëse deri në destinacionin përfundimtar të shitjes.*
*Ne argumentimin tone ne mund te parashtronim teknikisht nga ana jone edhe kode apo fatura te tjera homologe te kompanive te siperpermenduar (Febest, Impergom, Orginal Birth, Metelli dhe BGA) se bashku me cdoganimet e tyre. Kjo menyre intrepretimi nuk e ndryshon aspak faktorin e te qenurit ne partneritet me furnizuesit e mesiperm sikunder edhe me-Japanparts, per-te cilin kemi paraqitur dokumenta, te cilat e vertetojne ne menyre te patjetersueshme te bashkepunimit reciprok si distributor i markes JAPKO per Shqiperine (bashkelidhur edhe deklaratat doganore, faturat si dhe deklarimi i distributorit te autorizuar per marken JAPKO)*
*Nga ana e AK, Oferta jone duhet te klasifikohet si nje Oferte e vlefshme, pasi: Se pari, eshte OFERTA ME CMIM ME TE ULET ( 30% nen fondin limit)*
*Se dyti, eshte e argumentuar 100% persa i perket, si vijon:*
*a) anes ekonomike*
*b) zgjidhje teknike te ofruar*
*c) origjinalitetit te mallrave*
*d) zbatueshmerise detyrimeve ... etj .. etj*
*Nga ana tjeter, pervec sa me siper, ne baze te LPP dhe VKM 914, perpara klasifikimit (kualifikimit, ose skualifikimit) i kerkon Operatorit Ekonomik dokumenta shtese justifikimi deri ne bindjen e plate nese ky OE i ploteson apo Jo keto kerkesa,*
*Theksojme qe konkretisht, ne rastin e ofertes tone, edhe pse eshte OFERTA ME CMIM ME TE ULET ( 30% poshte fondit limit) kemi te bejme me nje argumentim te plote, voluminoz dhe te orjentuar, te sqaruar plotesisht sipas kerkesave tuaja,*
*Sa me siper pretendimi i AK per kete pike, nuk qendron.*
*Perfundimisht kerkojme riklasifikim te ofertave, duke here te mundur klasifikimin e ofertes tone, pasi i ploteson te gjitha kerkesat e vendosura nga AK ne DST[......]*

II.6. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit më anë të shkresën nr.1543/2 prot, datë 11.08.2020, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik "Alstezo"sh.p.k., duke e refuzuar atë me pretendimin si më poshtë:

*"[...]Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e here ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Alstezo" SHA, pretendimet e parashtruara ne ankese mbi skualifikimin e ofertes se tij konstatoi se: Per ofertuesin "Alstezo" SHA, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar dhe dhene automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 30.07.2020, arsyet e skualifikimin te ofertes se tij si vijon: "Ofertuesi nuk arriti te paraqese dokumentacion provues per elementet e vecanta te ofertes ekonomike anomalisht te ulet sipas nenit 56 te LPP-se, e konkretisht ne shkresen me nr.34/1prot., date 28. 07.2020 me lende: "Dorezim dokumentacioni lidhur me sqarimin e ofertes ekonomike" te protokolluar ne organin qendror bleres ABP me nr. 1499/1 prot., date 29.07.2020, rezulton se:-Referuar dokumentacionit dhe tabeles se paraqitur nga vete ofertuesi "ALSTEZO" SHA, te emertuar "Tabela permbledhese me te dhenat per sqarimin e ofertes ekonomike ", mungon dokumentacioni provues dhe sqarues per cmimet per njesi per 1 (nje) ze sherbimi e konkretisht per automjetin: Autoveture, Marka: Chevrolet, Tipi Aveo, Viti i Prodhimit 2009, Lenda djegese Benzine, Nr. Shasise: KLJ SF48EJAB040476, per zerin e sherbimit: "Furnizim & vendosje sensor oksigjeni "; -Referuar dokumentacionit dhe tabeles se paraqitur nga ofertuesi "ALSTEZO" SHA, te emertuar "Tabela permbledhese me te dhenat per sqarimin e ofertes ekonomike ", mungon dokumentacioni provues dhe sqarues per cmimet per njesi per zerat e sherbimeve per automjetet si me poshte:*

*I. Lloji: Autoveture, Marka: Chevrolet , Tipi Aveo, Viti i Prodhimit 2009, Lenda diegese Benzine ,Nr. Shasise: KLJSF48EJAB040476 e konkretisht:*

*1. Furnizim&vendosje rryp faze motori;*
*2. Furnizim&vendosje guarnicion testate;*
*3. Furnizim&vendosje bobine ndezje;*
*4. Furnizim&vendosje termostat nxehtesie;*
*5. Furnizim&vendosje freksioni;*
*6. Furnizim&vendosje pompe freksioni e poshtme;*
*7. Furnizim&vendosje kushinet moco rrote e pasme*
*8. Furnizim&vendosje diskfrenimi te pare*
*9. Furnizim&vendosje ferro ta frenimi te para*
*10. Furnizim&vendosje ferro ta frenimi te pas me*
*11. Furnizim&vendosje krah avantreni te poshtem*
*12. Furnizim&vendosje gomina krah avantreni te medha;*
*13.Furnizim&vendosje gomina ekuilibratos te pare;*
*14. Furnizim&vendosje kushinet suport amortizatori;*

*II. Lloji: Fuoristrad, Marka: LandRover, Tipi Defender, Vitii Prodhimit 2000, Lenda diegese Diezel Nr. Shasise: SALLDHMF8VA134072Nr.Shasise: EVE222JKZ5E006263,e konkretisht:*

*1. Furnizim&vendosje freksioni*
*2. Furnizim&vendosje pompe freksioni e poshtme*
*3. Furnizim&vendosje kryq transmesioni*
*4. Furnizim&vendosje kushinet moco rrote e pasme*
*5. Furnizim&vendosje kushinet moco rrote e pare*
*6. Furnizim&vendosje koke paraleli*
*7. Furnizim&vendosje ferro ta frenimi te para*
*8. Furnizim&vendosje ferro ta frenimi te pasme*

*III. Lloji: Fuoristrad, Marka: Mitsubish, Tipi Paiero, Viti i Prodhimit 2000, Lenda diegese Diezel; Nr. Shasise: JMBONV440XJ000J908, e konkretisht:*

*1. Furnizim&vendosje grup termostati nxehtesie*
*2. Furnizim&vendosje freksioni*
*3. Furnizim&vendosje pompe freksioni e siperme*
*4. Furnizim&vendosje pompe freksioni e poshtme*
*5. Furnizim&vendosje kemb ridoto*
*6. Furnizim&vendosje kushinet moco rrote e pasme*
*7. Furnizim&vendosje gjysmeboshte te pare te jashtem*
*8. Furnizim&vendosje moco rrote te para*
*9. Furnizim&vendosje kushinet moco rrote e pare*
*10. Furnizim&vendosje braco grup timoni*
*11. Furnizim&vendosje koke paraleli*
*12. Furnizim&vendosje ferro ta frenimi te para*
*13. Furnizim&vendosje ferro ta frenimi te pasme*
*14. Furnizim&vendosje pompe frenimi*
*15. Furnizim&vendosje koke krah avantreni siperm*
*16. Furnizim&vendosje koke krah avantreni poshtem*
*17. Furnizim&vendosje stabilizator i pare*
*18. Furnizim&vendosje gomina ekuilibratori te pare*
*19. Furnizim&vendosje gomina ekuilibratori te pasem;*

*IV. Lloji: Fuoristrad, Marka: Mitsubish, Tipi Paiero, Viti i Prodhimit 2000, Lenda diegese Benzine; Nr. Shasise: JMYONAJJOXJ000JJ8 e konkretisht:*

*1.Furnizim&vendosje termostat sistemftohje ne motor;*
*2. Furnizim&vendosje ferrota frenimi te para;*
*3. Furnizim&vendosje pompe frenimi;*

*V. Lloji: Fuoristrad, Marka: Hyundai, Tipi Galloper Viti i Prodhimit 2000, Lenda diegese Diezel; Nr. Shasise: KMXNLJDPVUJ76236, e konkretisht:*

*1. Furnizim&vendosje braco grup timoni*
*2. Furnizim&vendosje koke paraleli*

*3. Furnizim&vendosje ferrota frenimi te para*

*4. Furnizim&vendosje koke krah avantreni siperm;*

*VI. LLoji mikrobuz maraca Hyndai, Tipi H-1 Viti i Prodhimit 2014, Lënda Djegëse Diezel; Nr. Shasisë; KMHWH81KAFU690324, e konkretisht*

1. *Furnizim &vendosje freksioni;*
2. *Furnizim& vendosje ferrota frenimi të para;*
3. *Furnizim &vendosje tiran të stabizilator të pasëm;*

*Operatori ekonomik "ALSTEZO" SHA, per te gjithë zerat e shërbimeve te citura me siper ka paraqitur deklarata doganore me ane te te cilave provohet se ka importuar pjese te ndryshme kembimi per automjete nga kompania "Japanparts S.r.l", kompani e cila nuk rezulton te jete deklaruar nga ana e ofertuesit si prodhuese ose distributore i autorizuar nga prodhuesi ne perpmbushje te kriterit te percaktuar ne piken 8 te seksionit 2.3 "Per kapacitetin teknik", pra si nje nga kompanite ku ofertuesi do te furnizohet me pjese kembimi origjinale per realizimin e zerave te sherbimeve per automjetet objekti ketij objekti prokurimi. Persa me siper, edhe pas shqyrtimit te te gjithe informacionit te paraqitur, nuk krijohet bindja se oferta eshte e rregullt ne te gjitha elementet e saj ne perputhje me nenin 56 te LPP-se, ne drejtim te origjinalitetit te mallrave per kryerjen e ketyre sherbimeve kerkese e percaktuar ne dokumentat e tenderit. " Komisioni i Shyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Alstezo" SHA dhe konstatoi: Ne nenin 66 pika 5 te VKM nr.914 date 29.12.2014 per "Miratimin e rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar parashikon se "Pas korrigjimit te gabimeve aritmetike, komisioni i vleresimit te ofertave verifikon nese ofertat e vlefshme jane ose jo me cmim anomalisht te ulet sipas formules se percaktuar ne dokumentet standarde te tenderit. Perllogaritja e ofertes anomalisht te ulet behet ne menyrat e meposhtme: - Ne rastin kur jane te vlefshme dy ose me pak oferta, ne perputhje me nenin 56 te LPP, oferta vleresohet anomalisht e ulet kur ajo eshte ulur me shume se 25% e fondit limit te perllogaritur. Ne rastin kur jane te vlefshme tre ose me shume oferta, ne perputhje me nenin 56 te LP P, oferta vleresohet anomalisht e ulet nese vlera e saj do te jete me e vogel se 85% e mesatares se ofertave te vlefshme. Nese nje apo disa oferta vleresohen si anomalisht te uleta, komisioni i vleresimit te ofertave duhet te kerkoje sqarime nga ofertuesit, perpara se te marre vendim per kuali.fikimin ose jo te tyre, ne perputhje me nenin 56 te LPP. Ne cdo rast ofertuesi ka detyrimin te argumentoje dhe te dokumentoje me prova shkresore sqarimet per elementin/elementet e vecanta te ofertes, ne perputhje me kerkesat e nenit 56 te LPP." Nga shqyrtimi i ofertes ekonomike te ofertuesit "Alstezo" SHA , oferta ekonomike e paraqitur, ne zbatim te nenit 66 pika 5 te VKM nr.914 date 29.12.2014 per "Miratimin e rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar, rezulton anomalisht e ulet. Ne pikat 1 dhe 2 te nenit 56 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikon se: "Kur autoriteti kontraktor veren se nje ose me shume oferta per kontratat e mallrave, puneve apo sherbimeve jane anomalisht te uleta, ai, perpara se te vazhdoje me procesin e vleresimit te ofertave, i kerkon operatorit ekonomik perkates te paraqese me shkrim dhe brenda 3 diteve pune shpjegime per elemente te vecanta te ofertes, per: a) anen ekonomike te metodes se ndertimit, procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara; b) zgjidhjet teknike te*

*ofruara dhelose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem, qe ka ofertuesi per kryerjen e punimeve, per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve; c) origjinalitetin e puneve, mallrave apo te sherbimeve, te propozuara nga ofertuesi; ç;) zbatueshmerine e detyrimeve, qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te kryhet puna, sherbimi apo ku do te sigurohet furnizimi." Autoriteti kontraktor i verifikon këto elementë duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementët e saj. Në zbatim të nenit të sipërcituar në datën 24.07.2020 KVO me anë të shkresës nr. 1499 prot me objekt "Kërkesë për analaliza në lidhje me ofertën anomalisht të ulët", i ka kërkluar ofertuesit "Alstezo" sha sqarim për ofertën e keonomike për procedurën e prokurimit "Riparim mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë Vendiore të Policisë Elbasan". Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka kerkuar sqarimit si me poshte vijon: Perpara se te vazhdojme me procesin e vleresimit te ofertave, ju kerkojme te paraqisni me shkrim ne rruge elektronike dhe brenda 3 diteve pune shpjegime per elemente te vecanta te ofertes tuaj, per: a) anen ekonomike te procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara; b) zgjidhjet teknike te ofruara dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem, qe ju keni per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve; c) origjinalitetin e mallrave apo te sherbimeve, te propozuara nga ana juaj; ç) zbatueshmerine e detyrimeve, qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te kryhet sherbimi apo ku do te sigurohet fumizimi. Po ashtu, ju njoftojme se keni detyrimin te argumentoni dhe te dokumentoni me prova shkresore sqarimet per elementin/elementet e vecanta te ofertes, ne perputhje me kerkesat e nenit 56 te LPP. Autoriteti kontraktor do t'i verifikoje keto elemente dhe ne baze te informacionit te paraqitur nga anajuaj, mund ta pranoje oferten ose mund ta refuzoje ate, nese pas shqyrtimit te informacionit te paraqitur nga ana juaj nuk bindet se ajo eshte e rregullt ne te gjitha elementet e saj. Nepermjet shkreses nr. 34/1 prot., date 28.07.2020 (protokolluar me tonen nr. 1499/1 prot., date 29.07.2020) ofertuesi "Alstezo" SHA brenda afatit kohor te percaktuar, ka argumentuar oferten anomalisht te ulet. Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga ana e ofertesit rezulton se ne permbushje te parashikimeve te nenit 56 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar, jane dorezuar pershkrime narrative si edhe dokumentacion shoqerues dhe provues mbi argumentimin ligjor, teknik dhe ekonomik te ofertes se dorezuar ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike, per proceduren e prokurimit objekt "Riparim dhe mirembajtje automjetesh per Drejtorine Vendore te Policise Elbasan". Konkretisht, ne lidhje me parashikimet e nenit 56, te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, ofertuesi "Alstezo" SHA ka dorezuar dokumentacion per argumetnimin e ofertes se tij. Ne dokumentacionin e dorezuar ofertuesi gjithashtu jane paraqitur deklarata doganore me ane te te cilave provohet se ka importuar pjese te ndryshme kembimi per automjete nga kompania "Japanparts S.r.l". Nga verifikimi i dokumentacionit te dorezuar ne sistemin e prokurimit elektronik, kompania "Japanparts S.r.l" nuk rezulton te jete deklaruar nga ana e ofertuesit si prodhues ose distributor i autorizuar nga prodhuesi si nje nga kompanite ku ofertuesi do te fumizohet me pjese kembimi origjinale. Sa me siper eshte gjykuar se me ane te dokumentacionit te dorezuar ofertuesi "Alstezo" SHA nuk permbush kushtet kumulative te kerkuara nga ligji i posacem ne drejtim te argumentimit te ofertes*

*ekonomike anomalisht te ulet. Per arsyet e me siperme pretendimi i ofertuesit "Alstezo" SHA nuk pranohet. Sa me siper, ju bejme me dije se kunder vendimit te organit qendror bleres mund te behet ankim ne Komisionin e Prokurimit Publik, ne perputhje me nenin 63, pika 6, te LPP.[...]"*

II.7. Në datën 19.08.2020 operatori ekonomik "Alstezo" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresave nr. 1653/1prot., datë 31.08.2020, protokolluar me tonën në datën 03.09.2020, dhe nr.2064/1prot., datë 13.10.2020 protokolluar me tonën në datën 13.10.2020, janë depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacionet e autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

## III

## Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

## Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me argumentin se *"Ofertuesi nuk arriti të paraqesë dokumentacion provues për elementet e vecanta të ofertës ekonomike anomalisht të ulët sipas nenit 56 të LPP-së, e konkretisht në shkresën me nr.34/1prot., datë 28.07.2020 me lëndë: "Dorëzim dokumentacioni lidhur me sqarimin e ofertës ekonomike" të protokolluar në organin qendror blerës ABP me nr. 1499/1 prot., datë 29.07.2020, rezulton se: - Referuar dokumentacionit dhe tabelës së paraqitur nga vetë ofertuesi "ALSTEZO" SHA, të emërtuar "Tabela përmbledhëse me të dhënat për sqarimin e ofertës ekonomike", mungon dokumentacioni provues dhe sqarues për cmimet për njësi për 1(një) zë shërbimi e konkretisht për automjetin: Autoveturë, Marka: Chevrolet , Tipi Aveo, Viti i Prodhimit 2009, Lënda djegëse Benzine,Nr. Shasisë: KL1SF48WJAB040476, për zërin e shërbimit: "Furnizim&vendosje sensor oksigjeni"; - Referuar dokumentacionit dhe tabelës së paraqitur nga ofertuesi "ALSTEZO" SHA, të emërtuar "Tabela përmbledhëse me të dhënat për sqarimin e ofertës ekonomike", mungon dokumentacioni provues dhe sqarues për cmimet për njësi për zërat e shërbimeve për automjetet si më poshtë: I. Lloji: Autoveturë, Marka: Chevrolet , Tipi Aveo, Viti i Prodhimit 2009, Lënda djegëse Benzine ,Nr. Shasisë: KL1SF48WJAB040476 e konkretisht:*
*1.Furnizim&vendosje rryp faze motori;*
*2. Furnizim&vendosje guarnicion testate;*
*3. Furnizim&vendosje bobinë ndezje;*
*4.Furnizim&vendosje termostat nxehtësie;*
*5. Furnizim&vendosje freksioni;*
*6. Furnizim&vendosje pompë freksioni e poshtme;*

*7. Furnizim&vendosje kushinet moco rrote e pasme*
*8. Furnizim&vendosje disk frenimi të parë*
*9. Furnizim&vendosje ferrota frenimi të para*
*10. Furnizim&vendosje ferrota frenimi të pasme*
*11. Furnizim&vendosje krah avantreni të poshtëm*
*12. Furnizim&vendosje gomina krah avantreni të mëdha;*
*13. Furnizim&vendosje gomina ekuilibrator të pare;*
*14. Furnizim&vendosje kushinet suport amortizatori;*
*II. Lloji: Fuoristrad, Marka: Land Rover, Tipi Defender, Viti i Prodhimit 2000, Lënda djegëse Diezel Nr. Shasisë: SALLDHMF8VA134072Nr. Shasisë: WVWZZZ1KZ5W006263, e konkretisht:*
*1. Furnizim&vendosje freksioni*
*2. Furnizim&vendosje pompë freksioni e poshtme*
*3. Furnizim&vendosje kryq transmesioni*
*4. Furnizim&vendosje kushinet moco rrote e pasme*
*5. Furnizim&vendosje kushinet moco rrotë e pare*
*6. Furnizim&vendosje kokë paraleli*
*7. Furnizim&vendosje ferrota frenimi të para*
*8. Furnizim&vendosje ferrota frenimi të pasme*
*III. Lloji: Fuoristrad, Marka:Mitsubish, Tipi Pajero, Viti i Prodhimit 2000, Lënda djegëse Diezel; Nr. Shasisë: JMBONV440XJ001908, e konkretisht:*
*1. Furnizim&vendosje grup termostati nxehtësie*
*2. Furnizim&vendosje freksioni*
*3. Furnizim&vendosje pompë freksioni e sipërme*
*4. Furnizim&vendosje pompë freksioni e poshtme*
*5. Furnizim&vendosje këmb ridoto*
*6. Furnizim&vendosje kushinet moco rrote e pasme*
*7. Furnizim&vendosje gjysmëboshte të parë të jashtëm*
*8. Furnizim&vendosje moco rrote të para*
*9. Furnizim&vendosje kushinet moco rrote e parë*
*10. Furnizim&vendosje braço grup timoni*
*11. Furnizim&vendosje kokë paraleli*
*12. Furnizim&vendosje ferrota frenimi të para*
*13. Furnizim&vendosje ferrota frenimi të pasme*
*14. Furnizim&vendosje pompë frenimi*
*15. Furnizim&vendosje kokë krah avantreni sipërm*
*16. Furnizim&vendosje kokë krah avantreni poshtëm*
*17. Furnizim&vendosje stabilizator i parë*
*18. Furnizim&vendosje gomina ekuilibratori të parë*
*19. Furnizim&vendosje gomina ekuilibratori të pasëm;*
*IV. Lloji: Fuoristrad, Marka:Mitsubish, Tipi Pajero, Viti i Prodhimit 2000, Lënda djegëse Benzine; Nr. Shasisë:*
*JMYONA110XJ000115 e konkretisht:*

*1. Furnizim&vendosje termostat sistem ftohje në motor;*
*2. Furnizim&vendosje ferrota frenimi të para;*
*3. Furnizim&vendosje pompë frenimi;*
*V. Lloji: Fuoristrad, Marka : Hyundai, Tipi Galloper Viti i Prodhimit 2000, Lënda djegëse Diezel; Nr. Shasisë:*
*KMXNL1DPVU176236, e konkretisht:*
*1. Furnizim&vendosje braço grup timoni*
*2. Furnizim&vendosje kokë paraleli*
*3. Furnizim&vendosje ferrota frenimi të para*
*4. Furnizim&vendosje kokë krah avantreni sipërm;*
*VI. Lloji: Mikrobuz, Marka : Hyundai, Tipi H-1 Viti i Prodhimit 2014, Lënda djegëse Diezel; Nr. Shasisë:*
*KMHWH81KAFU690324, e konkretisht:*
*1. Furnizim&vendosje freksioni;*
*2. Furnizim&vendosje ferrota frenimi të para;*
*3. Furnizim&vendosje tirantë stabilizator të pasëm*
*Operatori ekonomik "ALSTEZO" SHA, për të gjithë zërat e shrbimeve të citura më sipër ka paraqitur deklarata doganore me anë të të cilave provohet se ka importuar pjesë të ndryshme këmbimi për automjete nga kompania "Japanparts S.r.l", kompani e cila nuk rezulton të jetë deklarur nga ana e ofertuesit si prodhuese ose distributore i autorizuar nga prodhuesi në përpmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën 8 të seksionit 2.3 "Për kapacitetin teknik", pra si një nga kompanitë ku ofertuesi do të furnizohet me pjesë këmbimi origjinale për realizimin e zërave të shërbimeve për automjetet objekti këtijobjekti prokurimi. Përsa më sipër, edhe pas shqyrtimit të të gjithë informacionit të paraqitur, nuk krijohet bindja se oferta është e rregullt në të gjitha elementët e saj në përputhje me nenin 56 të LPP-së, në drejtim të origjinalitetit të mallrave për kryerjen e këtyreshërbimeve kërkesë e përcaktuar në dokumentat e tenderit.",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se, në datën 27.07.2020 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë autoritetit kontraktor me anë të shkresës datë 27.07.2020 me objekt "Kërkesë për informacion mbi ofertën anomalisht të ulët", i ka kërkuar operatorit ekonomik "Alstezo sh.p.k. sqarim për ofertën ekonomike me vlerë 1.999.700 lekë, si më poshtë vijon:

*"[...]Në mbështetje të nenit 56 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar; të nenit 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; të pikës 4.1 të Manualit nr.02 datë 06.02.2018 të APP-së; të pikës 3.3 të DT, në lidhje me procedurën e prokurimit "Kërkesë për propozim" –Shërbime – Marrëveshje kuadër me disa operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 12 (dymbëdhjetë) muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër, me objekt: "Riparim, mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan", me fond limit: 2,832,800 (dy milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind) lekë pa TVSH dhe me nr. REF-64933-07-09-2020, e zhvilluar me datë 21.07.2020, ora 11.00, ju njoftojmë se gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të*

*ofertave, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është konstatuar se oferta e paraqitur nga ana juaj rezulton anomalisht e ulët. Përpara se të vazhdojmë me procesin e vlerësimit të ofertave, ju kërkojmë të paraqisni me shkrim / në rrugë elektronike dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës tuaj, për: a) anën ekonomike të procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara; b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ju keni për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve; c) origjinalitetin e mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ana juaj; ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. Po ashtu, ju njoftojmë se keni detyrimin të argumentoni dhe të dokumentoni me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. Autoriteti kontraktor do t'i verifikojë këto elemente dhe në bazë të informacionit të paraqitur nga ana juaj, mund ta pranojë ofertën ose mund ta refuzojë atë, nëse pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ana juaj nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. Për shpejtësi veprimesh, kërkesa ju dërgohet edhe në formë elektronike në ëëë.app.gov.al . […]"*

III.1.2 Referuar sistemit të prokurimeve elektronik rezulton se në datën 28.07.2020 operatori ekonomik "Alstezo" sh.p.k. ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor përgjigjen për kërkesën anomalisht të ulët.

III.1.3. Me anë të shkresës së mësipërme, operatori ekonomik "Alstezo" sh.p.k. ka argumentuar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

*"[…]Konkretisht, shpjegimin per elementet e vecanta te Ofertes tone po i paraqesim, si me poshte:*

*a) Lidhur me anën ekonomike te procesit të furnizimit dhe vendosjes së pjesëve të shërbimit riparimet apo sherbimit të mjeteve, po ju paraqesim tabelën bashkengjitur ketij materiali, ne të cilën jane të pershkruar ne menyre të sintetizuara dhe korrekte te gjitha te dhënat që nevojiten per nxjerrjen e kostos se pjeseve te kembimit dhe hakut te punes per cdo ze riparimi, si per montimin e pjeses ashtu edhe sherbimit (hakut punes ne vetvete). Konkretisht kemi bere analizen si vijon: Kemi paraqitur minimumin e blerjes pjeses kembimit ne Fabrikat (bashkëngjitur faturën e blerjes se mallit dhe dokumentin perkatës per cdoganimin e mallit me te cilen ne bashkëpunojmë dhe furnizohemi. I jemi referuar (pjeserisht) cmimeve te ofruara ne baze te listinove (price list) të Fabrikave dhe kompanive te cilat jane partneret tane dhe nga te cilat ne furnizohemi aktualisht me pjese këmbimi per automjetet. Kemi paraqitur koston e takses doganore edhe pse ne rastet kur kemi të bejmë me artikujt qe nuk jane te komunitetit EU. pra jane pa EURO 1 (pasi dihet që mallrat me Euro 1 e kane taksen doganore 0) ne e kemi konsideruar taksën doganore 2%. Kemi paraqitur koston e transportit nga depozita në Bari deri në Magazinat tona ndërkohë si kosto te transportit kemi marrë parasysh mesataren e kostos së transportit qe ështe paguar gjate se kryerjes se importeve nga Italia (fabrikat qe ne importojme pjesë kembimi janë vetem nga Italia) e cila në asnjë rast nuk e kalon masën deri në 2% max 5 %. Per rastin e pjeseve të këmbimit të furnizuara nga Kompanite FEDEST dhe BGA kosto e transportit deri ne destinacionin e magazinës tone në Shqipëri (Tirane) është 0, pasi është përfshire në cmimin e paraqitur në faturën përkatëse të kompanisë përkatëse. Kemi paraqitur kosto të montimit*

*të pjesës së këmbimit gjatë procesit të riparimit në këto raste kemi marrë parasyshkoston dhe hakun e punës e cila është llogaritur mbi bazën e kohës së punës që nevojitet për montimin e pjesës së këmbimt si dhe në kohën e kryerjes së shërbimit në rastin kur nuk kërkohet ndërrim të pjesës së këmbimit përfshirë të gjithë detyrimet fiskale dhe sigurimet shoqërore, pra si këto kosto të shërbimit apo riparimi në rastet kur ka vetëm hak pune, janë referuar cmimet sipas zërave të riparimit përkatësisht duke kalkuluar kohën e punës (puntorinë) shpenzimet për sigurimet shoqërore energjinë e harxhuar taksat vendore taksat për pasurinë etj….*

*Përfundimisht nga analiza e bërë rezulton që vlera totale e kostos së riparimit (përfshirë pjesën e këmbimit) është 1163860 lekë (në argumentimet tona shkresore kemi paraqitur edhe një tabelë ilustruese me të dhëna më konkrete sa më sipër)kundrejt ofertës 1999700 lekë.*

*Lidhur me zgjedhjet teknike :Shoqëia Alstezo sha ka një ekesperience 27 vjecare (krijuar në vitin 1993 si autoservis dhe pjesë këmbimi për automjet dhe sot është shoqëria lider në Shqipëri për riparimin dhe shërbimet e mjeteve si ato private ashtu edhe ato shtetërore. Kusht favorizues është pikërisht fakti që shoqëria ka disa pika kontrolli teknik shumë funksionale dhe modern të cilat shërbejnë në hyrje të mjetit për riparimin dhe kontrollin në dalje të tij. Pikat e kontrollit janë shumë modern dhe plotësojnë të gjitha parametrat teknike duke bërë të mundur kontrollin e mjetit pra diagnostikimin e difekteve dhe përcaktimin e gjëndjes teknike aktuale të mjetit në kohë reale lidhur me gjithë proceset e punës së nevojshme gjatë kontrollit, si para ashtu dhe pas procesit te riparimit te mjetit*

*Ne serviset qe ne disponojme kryhen gjithe proceset e punes per riparim te mjeteve, "nga A ne Z" sikurse jane ato motorrike, elektrike, elektronike, sistem ushqimi, percaktimi i nivelit te gazrave (lidhur me ndotjen e ambjentit) pastrimin e motorrit me H2, pastrimin e marmides katalitike me pajisjet bashkekohore PDF (teknologjie vitit 2019-2020, ... etj.) Reparti i karrocerise (riparimi llamarines dhe bojatisja) jane me modernet ne vend dhe ne rajon duke filluar qe nga repartet e zmontimit te mjetit, drejtimit te shasive, riparimit llamarines, lyerjes me boje ne furra moderne,.etj. Personeli Inxhinierik i shoqerise ALSTEZO sha eshte i specializuar dhe diplomuar ne shtetet perendimore, po ashtu edhe personeli tjeter teknik, i cili eshte i pajisur me deshmite profesionale, te cilat jane te konkretizuara nëpërmjet detyrave te percaktuara ne kontarten e punes perkatesisht per cdo punemarrës në vecanti.*

*Sa i perket orgiinalitetit te mallrave, Shoqeria ALSTEZOsha eshte importuese direkt e të gjitha pajisjeve të këmbimit që nevojiten për riparimin e mjeteve. Importi bëhet në rang produkti (multimarket) dhe disponibiliteti i pjesëve të këmbimit është 100% në kohë reale. Për porosi te vecanta emergjente ato organizohen nëpër fabrikat që në bashkëpunojmë dhe kemi partneritet të cilat e dërgojnë pjesën e këmbimit me poste prioritare kështu që propabiliteti mungesa e pjesëve të këmbimit të cfarëdo natyre thuajse 0. Nderkohe, kemi marrdhenie me koncesionaret dhe perfaqesite e pjeseve te kembimit me te fuqishme ne Bari (ltali) gjithashtu per raste emergjente te porosive te vecanta, te cilat sigurohen per 24 ore.*

*Lidhur me zbatueshmerine e detyrimeve: Shoqeria ALSTEZO sha, ka ambjentet e punes shume bashkekohore dhe me standartet e nje performance Europiane. Nga ana e personelit te shoqerise zbatohen me rigorozitet dhe displine te vazhdueshme te gjitha rregullat e sigurimit teknik. Aktualisht ne menyre te vecante, po zbatohen rregullat e vendosura nga organet kompetente saj perket "Covid 19".*

*Te gjitha keto perparesi sa me siper, garantojne realizimin e kesaj procedure, pa as mete voglin dyshim. Nderkohe duke e falenderuar KVO paraprakisht per kete bashkepunimin, ne kemi shprehur gatishmerine qe "mbetemi ne dispozicionin e AK per cdo sqarim te metejshem qe mund t 'ju nevojitej, sa me siper "*

III.1.4. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikon se *"[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për: a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara; b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve; c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi; ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. 2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...]".*

III.1.5. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar parashikon se *" Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni 7 i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni I vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]"*

III.1.6. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik "Alstezo" sh.p.k. si edhe nga përllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se oferta ekonomike në vlerën prej 1,999,700 lekë pa TVSH, në zbatim të nenit 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për

“Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, rezulton anomalisht e ulët. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor ka vepruar drejtë kur gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave i ka kërkuar informacion të detajuar operatorit ekonomik “Alstezo. sh.p.k., në zbatim të nenit 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III.1.7. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar si e tillë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të aktit nomrativ në zbatim të ligjit VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjen teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi, duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin si dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët, është në disa drejtime, ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore, të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuara si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë

dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimues, K.P.P. gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin të katër kushtet kumulative të parashikuara nga neni 56 i LPP-së.

III.1.8. Nga verifikimi i bërë nga Komisioni i Prokurimit Publik rezulton se operatori ekonomik "Alstezo" sh.a. ka paraqitur analizë të kostos të ofertës së tij, sipas cmimeve për njësi, si dhe ka bashkëlidhur fatura tatimore dhe deklarata zhdoganimi, për të mbështetur analizën e tij. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se për të justifikuar cmimet e deklaruara në ofertë, për një pjesë të konsiderueshme të pjesëve të këmbimit, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fatura blerje nga shoqëria "Japanparts S.r.l.". Nga shqyrtimi i dokumetnacionit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik "Alstezo" sh.a., në përmbushje të kriterit 2.3.8, të shtojcës 7, të dokumentave të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në të cilën kërkohet: *"8.Operatori ekonomik duhet të provojë që pjesët e këmbimit, për të cilat do të kryhen shërbimet e kërkuara, janë të furnizuara nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Dokumenti duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, Ëebsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor, në rast verifikimi nga ana e tij."* rezulton se, për të provuar që pjesët e këmbimit, për të cilat do të kryhen shërbimet e kërkuara, janë të furnizuara nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, ankimuesi ka paraqitur autorizime prodhuesi/distributori nga kompanitë: "Original Birth S.p.a."; "Resistor S.r.l."; "Tecneco Filtri S.r.l."; "Cofle S.p.a."; "Metelli S.p.a."; "BG Automotive L.t.d."; "Febest Europe Distribution"; "Ëolflubes"; "Impergom S.r.l.". KPP riktheson se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, i cili duhet të jap analiza sa më të sakta dhe të qarta për bindur autoritetin kontraktor, si dhe në përputhje me kërkesat e këtij të fundit. Komisioni gjykon se përsa kohë operatori ekonomik ankimues, ka paraqitur autorizime prodhuesi/distrobutori nga kompanitë e mësipërme, do të thotë që për zbatimin e kontratës objekt prokurimi, pjesët e këmbimit që do të përdorë gjatë shërbimeve të kërkuara do të furnizohen nga kompanitë e mësipërme, e për rrjedhojë edhe ofertën e paraqitur duhet ta kishte përllogaritur bazuar në cmimet e pjesëve të këmbimit të furnizuara nga këto kompani. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, argumentimi i ofertës anomalisht të ulët, duke u bazuar në fatura blerje dhe cmime pjesësh këmbimi, të një kompanie për të cilën në ofertën e paraqitur në SPE nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi/distributori, cka presupozon që gjatë zbatimit të kontratës nuk do të furnizohet nga ky i fundit me pjesë këmbimi, atëherë analiza dhe dokumentacioni provues nuk mund të konsiderohen të rregullta për të justifikuar ofertën, pasi cmimet e kompanive për produktet e tyre janë variabël, e për këtë arsye cmimet e produkteve të blera nga një kompani, nuk mund të merren për bazë për të analizuar cmimet e produkteve të blera ose që do të blehen në një kompani tjetër. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur analiza dhe dokumentacion provues, të cilat nuk janë të sakta që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët, duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Rrjedhimisht Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik ankimues "Alstezo" sh.a. nuk është sjellë

argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në respekt të nenit 56 të LPP-së, si dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, ndaj oferta e këtij operatori duhet të qëndrojë e skualifikuar nga ana e këtij të fundit.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave* "*Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Alstezo" sh.a. për procedurën e prokurimit "*Kërkesë për propozim*", me nr. *REF-64933-07-09-2020* me objekt: "*Riparim, mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan*", me fond limit *2,832,800* lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën *21.07.2020*, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 981;Protokolli Datë 19.08.2020**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

| Anëtar | Anëtar | Anëtar |
|---|---|---|
| **Vilma Zhupaj** | **Lindita Skeja** | **Merita Zeqaj** |

**Kryetar**
**Jonaid Myzyri**

Jonaid Myzyri
Digitally signed by Jonaid Myzyri
Date: 2020.10.16 04:28:42 +02'00'